



Skllavëruetit e njerëzve dhe shfaqja e fuqisë së Perëndisë!

Për konferencën “Besimet fetare kundër trafikimit të qenieve njerëzore në Shqipëri”
8 Shkurt, 2021

Trafikimi i qenies njerëzore është një realitet tronditës sot.

Fjala “trafikim njerëzish” e bën fjalën e dikurshme “tregëti skllavërisht” të tingëllojë ndryshe dhe mund ta humbësh ngjashmërinë diabolike mes tregëtisë së sotme moderne dhe asaj të dikurshme që na revoltonte menjëherë sa e dëgjojmë me emrin e vet “skllavëri”.

Shifrat tregojnë një pamje shumë të shëmtuar të përhapjes së kësaj plaje shoqërore ndërkombëtare (\$150 Miljard përfitim në vit deri në 2014 me rreth 21 milion njerëz pranguar në skllavërinë e kohës tonë,¹ pa llogaritur shfrytëzime të tjera të njerëzve jashtë kontekstit të përkufizuar si skllavëri).

Arsyeja pse duhet të shqetësohemi thellësisht për këtë realitet është sepse skllavëria e sotme tregon që historia shumëshekullore nuk na ka ndryshuar neve si njerëz por, përkundrazi, pikërisht tregon se ne sot mund të përsërisim të njëjtat krime si baballarët tanë të shekujve të kaluar. Nuk është mirë që të ngushëllohemi duke menduar se këta skllavopronarë të rinj janë ndryshe nga ne që mblidhemi dhe flasim me indinjatë këtu në konferencë për trafikimin njerëzor apo skllavërinë moderne. Bibla ka një mënyrë për të na treguar që problemi i shfrytëzimit të tjetrit është i rrënjësor tek mëkati i Adamit dhe Eves që secili prej nesh gjithashtu trashëgon në vetvete dhe që mund ta quajmë thjesht egoizëm; përparësia e vetes time në gjithçka.

Një mënyrë për ta lexuar historinë e mëkatisht të Adamit dhe Eves është duke evidentuar frikën e shfrytëzimit nga tjetri kur ata të dy u ndanë nga Perëndia për shkak të mëkatisht dhe si rezultat i kësaj e panë që ishin lakuriq apo të pambrojtur në duart e njëri-tjetrit dhe patën frikë; patën frikë dhe u mbuluan për t’u fshehur me gjethe nga njëri-tjetri së pari. Në një botë ku i kemi mbyllur derën Perëndisë, ashtu si Adami me Even në zgjedhjen e tyre mëkatore të pavarësisht apo autonomisë, gjendemi përballë njeriut të frikshëm në egoizmin e vet që s’don t’ia dijë për tjetrin.

Kur ne Shqiptarët jetonim së bashku si fqinjë në të njëjtin qytet të vogël apo fshat në malet dhe luginat e shumta, njiheshim mirë me njëri-tjetrin prandaj nuk mund të shmangeshim nga përgjegjësia nëse i hynim në hak tjetrit, dhe kështu jeta ishte më e parashikueshme.

¹ Nga një hulumtim i shpejtë në internet për “human trafficking,” sipas International Labour Organization (ILO) këto janë të dhënat për fitimet në dollarë Amerikane deri në 2014 dhe numri i viktimeve të trafikimit deri në 2012, por sipas një sondazhi tjetër “2017 Global Estimates of Modern Slavery” për krime lidhur me trafikimin e njerëzve llogariten deri “40 milion njerëz si viktime të skllaverisë moderne në një ditë të zakonshme në 2016.”

Pas rënies së kufizimeve të ndryshme me rënien e komunizmit në Shqipëri, emigracioni dhe mësymja e metropolit me anonimitetin dhe papërgjegjshmërinë por dhe shpërbërjen familjare ka sjellë prej dekadash tashmë një realitet tjetër shoqëror ku kultura familjare dhe komunitare ka pësuar deformime nën trysninë e shumë faktorëve të rinj përfshi edhe internetin. Rezultati është një kontekst kaotik, ku nuk ka shpresë të dukshme për përgjegjshmëri dhe ku “e keqja” e dikurshme quhet “e mirë” dhe “e mira” quhet “e keqe”; ky dislokim gjeografik është edhe social edhe moral.

Konteksti shoqëror, ekonomik dhe politik mund të krijojë kështu hapësira të ndryshme për këtë realitet egoist të zemrës që të shprehet, dhe gjithmonë shprehja e egoizmit të papërgjegjshëm është e njëjta pamje e së keqes me lëndimin apo shkatërrimin e njerëzve të tjerë. Kjo sëmundje e mëkatit ka forma të ndryshme si shfaqet dhe në disa njerëz merr përmasa kriminale kurse në disa të tjerë shoqërohet me indiferencë ose injorancë jo më pak fajtoare por më pak të dukshme.

Njeriu i ndarë apo indiferent ndaj Perëndisë është një njeri i frikshëm!
Ata që kanë shpresën tek arsimimi apo tek emancipimi politik dhe shoqëror, tek ligjet njerëzore dhe tek drejtësia njerëzore kanë patur rastin të paktën ta mbajnë fitoren mbi skllavërinë qysh nga fitorja e dukshme mbi skllavërinë me Wilberforce (William Wilberforce 1759-1833) që i frymëzuar nga Bibla udhëhoqi ndalimin e tregëtisë/trafikimit të njerëzve si skllavëri në shekullin e 19të. Qysh atëhere nuk kanë munguar ligjet dhe as investimet për sistemin e drejtësisë apo deklaratat e Kombeve të Bashkuara dhe organizatat e panumërta joqeveritare, por realiteti tregon se sëmundja pjellëse e keqtrajtimit të tjetrit është e lidhur me natyrën mëkatore njerëzore që ka nevojë më shumë se sa ligje dhe arsimim; ka nevojë për dritë shpirtërore dhe besim zemre në Perëndinë që krijoi çdo njeri; që i krijoi në shëmbëlltyrën e vet, me dinjitet të patjetërsueshëm dhe llogaridhënie të paasgjësueshme nga vdekja; njeriu do japë llogari në këtë jetë por edhe në tjetrën sepse dora e Zotit është më e gjatë se drejtësia e pasigurtë njerëzore!

Raste të tilla si sot, kur flasim për plagë të tilla të pashëruara si shfrytëzimi kafshëror i njerëzve, trafikimi apo skllavërimi i njerëzve, janë rastet kur duhet të bëhet e qartë se vizioni fetar nuk mund të anashkalohet për të arritur një shoqëri të kulturuar; injorimi i besimit është vetëvrastja e njeriut siç duket nga plagët e shumta të vetëshkatërrimit dhe vetëskllavërimit që po diskutojmë sot me rrënjët tek shkatërrimi i familjes dhe moralit.

Vizioni fetar, apo këndvështrimi i frymëzuar nga nohuria e më të lartit, ka theksuar gjithmonë rëndësinë e ruajtjes së familjes nukleare si baza e një shoqërie të shëndetshme; ka theksuar kujdesin për vlerat që ruajnë funksionimin e familjes së shëndetshme; ka theksuar kujdesin për rritjen e fëmijëve nga prindërit e vet dhe kujdesin për të ndihmuar prindërit në përgjegjësinë e tyre prindërore.

Vizioni fetar apo këndvështrimi i informuar nga Krijuesi ka theksuar gjithmonë shenjtërinë e martesës dhe mosndarjen e seksit nga martesë për ta kthyer në një komoditet për shitje dhe blerje duke krijuar pikërisht atë treg ku skllavopronarët e rinj shfrytëzojnë më shumë se 20% të të trafikuarve sot² (apo mbi 50% në rastin Shqiptar³).

² Perseri sipas asaj llogaritje te permendur me lart nga ILO ne vitin 2012 qe e permend thjesht per t'ju referuar statistikave te njerezve qe studjojne realitetin kompleks duke imagjinuar qe mund te jete vetem pjesa qe duket e ajshbergut te turpit.

Vizioni fetar është i pazëvendësueshëm për të ruajtur pikën e referimit të së mirës dhe së keqes që njerëzit të mos budallepsen nga ideologjitë e “fluturimit më presh”⁴ për gjininë apo orientimin seksual duke humbur edhe logjikën morale.

Vizioni fetar apo ai këndvështrim i bazuar tek shkrimi i shenjtë është e vetmja bazë e mjaftueshme e sigurimit të arsyes për dinjitetin e çdo njeriu; nga ngjizja në vdekjen natyrale; pamvarësisht nga çfarëdo e metë mendore apo trupore; pamvarësisht nga disavantazhet sociale apo kulturore; pamvarësisht nga çdo cilësi jete apo statusi në peshoren njerëzore!

Dështimi i shoqërive tona sot, Shqiptare dhe të tjera, siç tregohet nga kjo plagë e thellë e trafikimit të qenieve njerëzore për komoditet konsumi, është një dështim i shumëanshëm dhe do ketë nevojë për reflektime dhe planifikime, investime dhe organizime të shumëllojshme por ajo që është e pazëvendësueshme është ndihma e Perëndisë në zemrat njerëzore.

Shqipëria ndoshta nuk është vendi më i prekur nga kjo plagë shoqërore dhe do ua lë statisticieneve apo punonjësve të ndryshëm socialë të na pikturojnë pamjen e saktë të gjendjes, por për mua ishte mjaft vetëm një informacion nga një rrugë në Bruksel. Nënkrjetarja e komunitetit tonë, që ishte e pranishme në ndihmë të një organizate që ndihmon luftën kundër skllavërisë së sotme në Bruksel, me pyeti: “Nga 35 prostituta në këtë rrugë të Brukselit, sa mendon ti se ishin Shqiptare?” Unë me hamendje thashë 5, por e vërteta ishte se nga 35 prostituta, Shqiptare ishin 34, dhe vetëm njëra diku nga Afrika! Për mua kjo është një shenjë e qartë që shkatërrimi i shoqërisë Shqiptare është shumë i thellë. Ato vajza janë ndoshta kushërirat e mia ose të tuat dhe ata që i kanë çuar atje janë kushërinjtë e mij ose të tutë!

Kush janë fajtorët e këtij realiteti? Ju tashmë e dini përgjigjen time kryesore: Jam unë dhe ti, në ngjashmërinë më të gjithë mëkatarët e tjerë por edhe me egoizmin tonë akomodues për rehatinë tonë dhe frikacake përballë fuqisë së “të fortëve”! Por sigurisht, faktorët e ndryshëm sociale dhe politikë në jetën e këtyre fatkeqëve dhe trafikantëve të tyre janë aktorët specifikë të realitetit të vështirë të përditshëm në shoqërinë tonë; janë padrejtësitë e njerëzve “të fortë” që përfitojnë ku të munden pa përgjegjshmëri; duke mbjellë varfëri me para të pista; me menjanim rrugaçi të konkurentëve; me kërcënim arrogant papunësie dhe mospagesë punë; me ryshfete të turpshme dhe me imoralitet të paturpshëm ndaj motrave dhe familjareve tanë.

Njëra prej atyre vajzave mendohej sikur ishte studente nga njerëzit e saj këtu në Shqipëri, kurse një tjetër tregonte për nënën e saj që me humbjen apo ndryshimet e një partie politike duhet të rrinte pa punë prandaj ajo “punonte” në pisllek. Humbja e fuqisë së familjes për të mbrojtur fëmijët e vet nga “kandidatët për martesë” të vajzave të tyre apo nga bashkëfshatarët ose komshinjtë e fortë që dalin nga burgu me lek dhe nuk kapen nga drejtësia kur këqtrajtojnë motrën tonë, është një histori që dëgjohet shpesh nga fatkeqët. Prandaj unë mendoj që nuk do mjaftojnë ligjet dhe programet rehabilituese për të adresuar këtë tragjedi të sotme; do duhet ndihma e Perëndisë për shërimin e shoqërisë sonë.

³ Sipas prezantimit të një parafolëseje në këtë konferencë sot.

⁴ Nuk me intereson etimologjia e kësaj shprehjeje por thjesht e them si ekuivalente të “fluturimeve me fshese” të shtriganeve neper filmat e zakonshëm vizatimorë që shohin edhe sot fëmijet para televizioneve. Gjithashtu duhet vecuar këtu (1) rasti i *ideologjise* imponuese të një vizioni të ri social për këto ceshtje që duhet ballafaquar me arsyen, logjikën dhe funksionin për të mirën e përgjithshme shoqërore sipas këndvështrimeve legjitime, nga (2) rastet specifike të *njerëzve* me mendimet e veta për gjendjen e tyre personale që duhen respektuar dhe mbrojtur nga sulmet demtuese të personit.

Unë kam besim se ashtu siç thotë Perëndia për popullin e tij në Bibël, Ai mund të bëjë të njëjtën gjë edhe për ne në Shqipëri sot. Ai ka thënë: “Në qoftë se populli im, i cili thirret me emrin tim, përulet, lutet, kërkon fytyrën time dhe kthehet prapa nga rrugët e këqija, unë do ta dëgjoj nga qielli, do t’i fal mëkatin e tij dhe do ta shëroj vendin e tij” (Bibla, 2 Kronikave 7:14). Fatmirësisht ka 30 vjet tashmë që shumë Shqiptarë kanë gjetur rrugën e lirisë së shpirtit dhe kurajos ballafaqese të së keqes shumëplanëshe, agresive dhe diabolike, dhe kam shpresë që këtu është baza e shërimit që mund të vije edhe për shoqërinë tonë sepse, përsëri, “Nëse Perëndia nuk ndërton shtëpinë, ata që ndërtojnë atë punojnë më kot” (Bibla, Psalmi 127).

Lufta kundër trafikimit skllavëror të njerëzve është një luftë e denjë dhe e perendishme prandaj ne të krishterët ungjillore jemi me gjithë zemër përkrah të gjithëve në këtë front. “Perëndia para ne prapa,” pa hequr dorë kurrë deri në fitore kundër skllavërisë shumëplanëshe të njeriut kur do shfaqet përsëri fuqia e dashurisë së Perëndisë në veprim!

Zoti ju bekoftë.

Pastor, Dr. Ylli H. Doçi
Kryetar i Vëllazërisë Ungjillore të Shqipërisë.